

koncept dokumenti do të përputhet me objektivin strategjik të PSAK 7.9, të cilat do të duhet të merren parasysh për shumëlojshmërinë e kërkesave për financim dhe kjo të lidhet edhe me elemente më të kontekstualizuara e të përshtatura për objektivat e universiteteve dhe vlerësimin e performancës së tyre.<sup>6</sup>

Ky koncept dokument rekomandon dy modele – variante për transformimin e këtyre universiteteve.

## 1) VARIANTI 1 – DY UNIVERSITETE PUBLIKE

- 1) UNIVERSITETI I PRISHTINËS DHE
- 2) UNIVERSITETI I DUKAGJINIT

### **UNIVERSITETI I PRISHTINËS** Struktura organizative dhe profilizimi

**Rektorati Prishtinë -  
KAMPUSI PRISHTINË**  
**Me 13 fakultet dhe të gjithë infrastrukturën ekzistuese**

#### **KAMPUSI GJILAN :**

1. Fakulteti Mekatronikës dhe
2. Fakulteti i Ballkanistikës

➤ **Dega Mjekësisë:**

- Programi i fizioterapisë

➤ **Dega e ekonomisë**

- Programi Banka financa e kontabilitet
- Programi i Menaxhmentit dhe Informatikës

<sup>6</sup> Rekomandim: Ministria duhet të marrë rolin udhëheqës në drejtimin dhe koordinimin e procesit të krijimit të profileve të dallueshme për universitetet e ndryshme. Megjithatë, kjo duhet të bëhet në bashkëpunim me universitetet në bazë të planeve strategjike që do të zhvillohen nga secili prej tyre (në përpunje me masat strategjike 7.9.3. të PSAK). Planet strategjike duhet të përfshijnë një deklaratë të qartë të misionit të tyre që përshkruan profilin e tyre dhe identifikimin e partnerëve më të mirë të mundshëm në industri në rajonin e tyre dhe në nivel kombëtar për të zhvilluar një strategji angazhimi si pjesë e planit të tyre strategjik. Për më tepër, planet strategjike duhet të tregojnë edhe atë se si çdo universitet synon të gjenerojë njedhjen e të ardhurave shtesë.